

**D E K R E T**  
**Nr. 3443, datë 26.8.2002**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE  
NË KOMUNËN DAJT, QARKU TIRANË**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës, si dhe të neneve 4 dhe 11, pika 5 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8780, datë 3.5.2001 bazuar në njoftimin e Kryeministrit,

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

Zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune në komunën Dajt, të Qarkut Tiranë, të zhvillohen ditën e dielë, datë 29 shtator 2002, ndërsa raundi i dytë të zhvillohet ditën e dielë, datë 13 tetor 2002.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**